

Plani i Veprimit për GP20 për Avancimin e Parandalimit, Mbrojtjes dhe Zgjidhjeve për Personat e Zhvendosur Brenda Vendit 2018-2020

Viti 2018 shënon 20-vjetorin e Parimeve Udhëzuese për Zhvendosjen Brenda Vendit (GP20) dhe paraqet mundësi të rëndësishme dhe unike për të gjitha palët e interesit që merren me zhvendosjen brenda vendit që të përshkallëzojnë punën e tyre, me dhe për PZHBV-të, dhe në të njëjtën kohë të nxisin të tjerët për të vepruar në këtë mënyrë.

Plani i Veprimit trevjeçar me shumë palë të interesit për avancimin e parandalimit, mbrojtjes dhe zgjidhjeve për personat e zhvendosur brenda vendit (PZHBV-të) për 2018-2020 u lansua në prill të vitit 2018 në Gjenevë.

Përse nevojitet plan veprimi për Kosovën?

Ministria për Komunitete dhe Kthim, me mbështetjen e Kordinatorës për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara, Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe Zyrën e Shefit të Misionit të Komisarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) në Kosovë, gjatë konferencës së organizuar më 26 qershor 2019 në Prishtinë, nxitën institucionet që t'i shtojnë përpjekjet e përbashkëta për gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme për personat e zhvendosur brenda vendit në Kosovë përmes fuqizimit të bashkëpunimit ndërministror, mbledhjes së të dhënave dhe mbylljes së qendrave kolektive.

Gjithashtu, u organizua ekspozita me fotografi për t'i adresuar nevojat dhe për t'i paraqitur kushtet e jetesës së PZHBV-ve të akomoduar në qendrat kolektive.



Cili është fokusi i Planit të Veprimit për GP20?

Përmirësimi i cilësisë së të dhënave dhe analizave mbi zhvendosjen brenda vendit

- ✓ Promovimi i koordinimit midis të gjitha palëve të interesit dhe avokimi i përbashkët për të dhëna/informata të sakta për të gjitha familjet/individët e zhvendosur brenda vendit në nivelin qendror dhe atë komunal.
- ✓ Avokimi për përfshirjen e pyetjeve që kanë të bëjnë me PZHBV-të në Pyetësorin e Regjistrimit të vitit 2021.

Promovimi, zhvillimi dhe zbatimi i kornizave kombëtare për të parandaluar dhe adresuar zhvendosjen brenda vendit

- ✓ Vetëdijesimi mbi Parimet Udhëzuese për Zhvendosjen Brenda Vendit (GPID) të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) përmes ngjarjeve/trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve me institucionet përgjegjëse për zbatimin e Rregullores (QRK) - nr. 02/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme.
- ✓ Avokimi i përbashkët për integrimin e prioritetëve tematike të GP20, veçanërisht duke marrë parasysh nevojën e domosdoshme për të theksuar rëndësinë e aplikimit të qasjeve holistike (qasje të tërësishme, pa anashkaluar apo neglizhuar ndonjë detaj)dhe shumëdimensionale,si dhe gjithashtu vëmendjen e shtuar ndaj qëndrueshmërisë dhe kushteve socio-ekonomike, duke përfshirë aspektin e cënueshmërive.
- ✓ Avokimi – duke përfshirë vlerësimin e boshllëqeve/problemeve që duhet të trajtohen nga dokumenti i ri i Strategjisë për Komunitete dhe Kthim 2019-2023.

Adresimi i zhvendosjes së zgjatur gjatë ndjekjes së zgjidhjeve për PZHBV-të

- ✓ Avokimi për funksionalizimin e komisionit ndërministror
- ✓ Integrimi i GP20 brenda një dimensionit rajonal, p.sh. bashkëpunimi rajonal ndërinstucional për zgjidhje të qëndrueshme për personat e zhvendosur nga Kosova – “Procesi i Shkupit”.
- ✓ Takimi për koordinimin e donatorëve të mundshëm – angazhimi në procesin e dialogut, partneritetit dhe mobilizimit të burimeve të udhëhequr nga qeveria në koordinim të ngushtë me palët e interesit dhe donatorët për të adresuar situatën e zgjatur të zhvendosjes në Kosovë.
- ✓ Sigurimi i gjithëpërfshirjes dhe bashkëpunimeve, si dhe krijimi i

lidhjeve me çdo program, politikë dhe projekt qeveritar, duke përfshirë nismat që do të ndërmerren për t'i adresuar nevojat dhe zgjidhjet për të mirën e PZHBV-ve. Të gjitha temat ndërsektoriale do të merren parasysh gjatë gjithë procesit, d.m.th. gjinia, rinia, të moshuarit, fëmijët, dhuna seksuale në baza gjinore, shëndetësia, arsimi, cenueshmëritë, etj.

- ✓ Sigurimi i qasjes gjithëpërfshirëse ndaj menaxhimit të qëndrueshëm mjedisor përgjatë planifikimit të zgjidhjeve dhe zbatimit të projektit.
- ✓ Mbështetja e zgjidhjeve të qëndrueshme për popullatën më të cenueshme, përfshirë PZHVB-të që banojnë në qendrat kolektive, përmes projekteve specifike që kanë ndikim të shpejtë.
- ✓ Përfshirja e kategorisë së PZHVB-ve/të kthyerve si grup i synuar specifik, brenda Planit të Punës për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Ekipit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNKT/SDG), rrjedhimisht, forcimi i partneriteteve brenda UNKT-së që më tej mund të shfrytëzohet për të mbështetur projektet e financuara nga Fondi i Përbashkët për OZHQ si dhe donatorët tjerë të mundshëm.
- ✓ Forcimi i komunikimit dhe rritja e vizibilitetit/ ose transparencës të Planit të Veprimit për GP20 – në koordinim të ngushtë me Koordinatorin Global për GP20.
- ✓ Inkurajimi i angazhimit të publikut përmes nismave dhe ngjarjeve për GP20.
- ✓ Hulumtimi i mundësisë për të ftuar Raportuesin Special për të Drejtat e Njeriut të PZHVB-ve.
- ✓ Sigurimi i përfshirjes së çështjeve të PZHBV-ve brenda Planit të Përbashkët për Zhvillim/Kornizës së Asistencës për Zhvillim të OKB-së (CDP/UNDAF) në përputhje me Agjendën 2030.

